

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për varreza: 45215400-1.

VLERA E FONDIT LIMIT: 8 328 562,03 (tetë milionë e treqind e njëzet e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy presje zero tre) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente, liçensë për zbatim punimesh:

Kategoria	Klasifikimi	Emërtimi
NP 1	A	Punime gjurmimi në tokë
NS 1	A	Punime për prishje ndërtimesh
NS 4	A	Punime rifiniture të muratimit dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
N-Z/A/7		Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë autoritetit kompetent, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë licencë profesionale të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt prokurimi, me kategoritë dhe klasifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, është vendosur në funksion të natyrës, kompleksitetit, karakteristikave teknike dhe vendndodhjes së punimeve që do të realizohen në kuadër të objektit “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”.

Kërkesa për kategorinë NP 1 “Punime gjurmimi në tokë”, lidhet drejtpërdrejt me punimet e gjurmimit dhe përgatitjes së terrenit të parashikuara në preventiv. Në kuadër të objektit janë parashikuar gjurmime dheu për themele dhe plinta me thellësi deri në 2 m, gjurmime me ekskavator me zinxhir dhe kovë 0.5 m³, ngarkim dhe shkarkim të materialeve në automjete, gjurmime manuale dhe transport të materialit të gjermuar, si dhe punime për përgatitjen dhe sistemimin e territorit. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohen kapacitete profesionale dhe teknike të përshtatshme për kryerjen e gjurmimeve sipas akseve, kuotave, dimensioneve dhe kushteve të terrenit të përcaktuara në projekt. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë NP 1 është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon garantimin e realizimit të sigurt dhe teknikisht korrekt të punimeve të gjurmimit dhe përgatitjes së terrenit.

Kërkesa për kategorinë NS-1 “Punime për prishje ndërtime”, lidhet me ndërhyrjet e parashikuara në preventiv për prerjen e strukturave prej betoni në kuadër të punimeve për veprat e artit dhe kanalizimet. Këto ndërhyrje kërkojnë realizim të kontrolluar të prerjes ose prishjes së elementeve ekzistuese, me qëllim përshtatjen e tyre me zgjidhjen teknike të projektuar dhe krijimin e kushteve për realizimin e elementeve të reja. Duke qenë se ndërhyrjet në struktura ekzistuese duhet të realizohen në mënyrë të kontrolluar dhe profesionale, kërkesa për kategorinë NS-1 është e lidhur me natyrën konkrete të punimeve dhe synon të garantojë realizimin e tyre në përputhje me projektin dhe kërkesat e sigursë teknike.

Kërkesa për kategorinë NS-4, që përfshin punime rifiniture të muraturës dhe punime të lidhura me to, si dhe rifinitura me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifinitura të natyrës teknike ndërtuese, lidhet me disa prej proceseve të parashikuara në preventiv. Në kuadër të objektit janë parashikuar punime suvatimi të fasadave me granil dhe çimento të bardhë, punime bojatisjeje të sipërfaqeve metalike, vendosje e portës metalike dekorative rrëshqitëse, punime të mbulimit të çatisë me panele sandwich, vendosje e pllakave prej guri, si dhe punime të ndryshme për përfundimin dhe sistemimin e elementeve të ndërtuara. Këto procese ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë përfundimtare, funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe pamjen e objektit dhe kërkojnë aftësi profesionale për realizimin e tyre sipas specifikimeve teknike dhe dokumentacionit të projektit. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë NS-4 është në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e punimeve të parashikuara.

Në mënyrë të veçantë, kërkesa për kategorinë N-Z/A/7, “Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane”, lidhet me vendndodhjen konkrete të objektit dhe statusin e veçantë të territorit ku do të realizohen punimet. Punimet objekt prokurimi do të zhvillohen dhe në Fshatin e Vjetër Qeparo, i cili është shpallur zyrtarisht Qendër Historike me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 07.09.2016, “Për shpalljen e qendrave historike të qyteteve dhe fshatrave”. Për shkak të këtij statusi, ndërhyrjet që do të realizohen në territorin e Fshatit të Vjetër Qeparo duhet të kryhen duke marrë në konsideratë karakterin historik dhe vlerat kulturore, arkitektonike dhe urbane të zonës. Punimet e parashikuara në preventiv, duke përfshirë sistemimin dhe zgjerimin e territorit, punimet e gërmimit, ndërhyrjet në struktura ekzistuese, punimet e betonit dhe betonarmesë, muraturën prej guri, suvatimet, punimet me materiale guri, vendosjen e pllakave, elementet metalike dhe rrethimin e territorit, duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me karakterin e zonës dhe të mos cenojnë vlerat e saj historike. Kërkesa për kategorinë N-Z/A/7 është vendosur pikërisht për të garantuar që operatori ekonomik që do të realizojë kontratën të disponojë kapacitetin profesional të nevojshëm për kryerjen e ndërhyrjeve në një territor me status të veçantë historik, duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, kërkesat e dokumentacionit teknik dhe zgjidhjen e projektit. Kjo kërkesë nuk lidhet vetëm me natyrën e veçantë të disa punimeve, por në mënyrë të drejtpërdrejtë me faktin se ato do të realizohen brenda një qendre historike, ku ndërhyrjet duhet të kryhen me kujdes të shtuar profesional dhe teknik.

Në këtë kuadër, kërkesa për kategorinë N-Z/A/7 lidhet me objektin dhe vendndodhjen e kontratës dhe synon të garantojë që ndërhyrjet në hapësirat e varrezave të fshatit të vjetër Qeparo të realizohen në përputhje me karakterin dhe vlerat e zonës historike. Kërkesa mbështetet në nevojën për respektimin e kuadrit ligjor për trashëgiminë kulturore, në veçanti të Ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe të akteve nënligjore dhe administrative që rregullojnë mbrojtjen dhe administrimin e qendrave historike.

Për operatorët ekonomikë të huaj, kërkesa për licencën profesionale do të përmbushet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke bërë njehsimin e licencës profesionale që disponojnë në vendin e origjinës pranë autoritetit kompetent në Republikën e Shqipërisë, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet

ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*.

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”*.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se *”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti

kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Përcaktimi i vlerës minimale prej 95% të vlerës limit të kontratës synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë reale dhe të konsoliduar në realizimin e punimeve të ngjashme, në një volum ekonomik të konsiderueshëm dhe të krahasueshëm me përmasat e kontratës objekt prokurimi. Ky nivel kërkesë është i arsyeshëm duke pasur parasysh se kontrata përfshin një kombinim të punimeve të prishjes, gërmimit, transportit, ndërtimit të shtresave konstruktive, betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve me gur natyral.

Kërkesa është vendosur duke respektuar përcaktimin ligjor sipas të cilit, për kontratat e punëve në procedurat e thjeshtuara, vlera e punëve të ngjashme të kërkuara në total gjatë pesë viteve të fundit nuk duhet të jetë më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Në rastin konkret, kërkesa prej 95% është më e ulët se kufiri maksimal prej 100% të vlerës limit të kontratës dhe, për rrjedhojë, qëndron brenda kufirit të përcaktuar nga kuadri ligjor.

Në përputhje me përcaktimin ligjor, kriteri është konceptuar në mënyrë alternative, duke parashikuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve të përvojës së ngjashme e bën ofertën të kualifikueshme. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë kanë mundësi të dëshmojnë kapacitetin e tyre profesional ose nëpërmjet realizimit të një pune të ngjashme për një objekt të vetëm, brenda kufirit të përcaktuar përkatësisht nga legjislacioni, ose nëpërmjet realizimit të disa punëve të ngjashme, vlera monetare totale e të cilave plotëson pragun e kërkuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjësish, të siguruar pranë organeve tatimore për muajin Gusht 2026.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë numrin minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës përkatëse të DST-së.

Operatori ekonomik i renditur i pari, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- *Listëpagesën e punonjësve, sipas formularit standard të deklarimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për muajin Gusht 2026;*
- *Vërtetim nga administrata tatimore që dëshmon numrin e punonjësve të siguruar nga operatori ekonomik për muajin Gusht 2026.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Përcaktimi i kriterit të kualifikimit sipas të cilit operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjës, të siguruar pranë organeve tatimore për muajin Gusht 2026, është bërë në përputhje me natyrën, kompleksitetin, volumin dhe afatin e realizimit të punimeve të parashikuara për objektin “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”.

Ky kriter është përcaktuar mbi bazën e një vlerësimi të nevojave reale për burime njerëzore, duke marrë në konsideratë zërat e punimeve të përfshira në preventiv, të cilat janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë angazhim të njëkohshëm të fuqisë punëtore në disa procese pune.

Në preventiv janë parashikuar, ndër të tjera, punime shpyllëzimi, përfshirë prerjen dhe sistemimin e pemëve dhe skarifikimin e barit; punime dheu, si transport materialesh ndërtimi, transport dheu me automjet, gjermime për themele dhe plinta me thellësi deri në 2 m, gjermime me ekskavator me zinxhir me kovë 0.5 m³, ngarkim dhe shkarkim në automjete, si dhe gjermime dheu me krah dhe transport manual deri në 10 m.

Gjithashtu, objekti përfshin ndërtimin e veprave të artit dhe kanalizimeve, punime në struktura betoni, punime betoni dhe beton-arme, përfshirë realizimin e brezave monolitë prej betoni C12/15, punime hekuri dhe beton-arme, shtresa betoni me rrjetë hekuri dhe vendosjen e hekurit të betonit me diametra 6–10 mm.

Në kuadër të objektit parashikohen edhe punime hidroizolimi dhe çatie, konkretisht mbulim çatie me panele sandwich, punime murature guri deri në lartësinë 3 m me llaç çimentoje M25, punime tavani dhe suvatimi, përfshirë suva fasade me granil dhe çimento të bardhë, si dhe punime bojatisjeje, punime të sipërfaqeve metalike dhe vendosje portash metalike dekorative rrëshqitëse. Po ashtu, në preventiv janë përfshirë punime të nënshtresave dhe shtresave në territorin e ndërtesave, si shtresa zhavorri, vendosja e pllakave prej guri të thjeshta, si dhe rrethimi me

kangjella dhe panele çeliku të zinguar. Këto punime kanë karakteristika të ndryshme teknike dhe kërkojnë angazhim të vazhdueshëm të punonjësve në procese të ndryshme, duke përfshirë punime manuale, punime ndërtimore, punime betoni e hekuri, punime guri, punime metalike dhe punime për sistemin e territorit.

Për përcaktimin objektiv të numrit minimal të punonjësve është marrë në konsideratë edhe sasia totale e orëve të punës, e përlllogaritur në bazë të preventivit, Manualit të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizave të kostove. Nga përlllogaritjet rezulton një ngarkesë totale prej 11 520 orësh pune.

Duke konsideruar një ditë pune prej 8 orësh, ngarkesa totale e punës përkthehet në:

$11\,520 \text{ orë pune} \div 8 \text{ orë/ditë} = 1\,440 \text{ ditë pune.}$

Duke qenë se afati i parashikuar për realizimin e kontratës është 90 ditë kalendarike, numri mesatar i punonjësve të nevojshëm për përballimin e kësaj ngarkese pune brenda këtij afati rezulton:

$1,440 \text{ ditë pune} \div 90 \text{ ditë} = 16 \text{ punonjës.}$

Për rrjedhojë, kërkesa për minimalisht 16 punonjës është rezultat i drejtpërdrejtë i raportit ndërmjet volumit të punës të përcaktuar në preventiv dhe afatit të ekzekutimit të kontratës.

Numri prej 16 punonjësish konsiderohet i nevojshëm për të garantuar që punimet të realizohen brenda afatit 90-ditor, duke mundësuar organizimin dhe zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës, në funksion të respektimit të grafikut të punimeve dhe të kërkesave teknike të projektit.

Kërkesa për disponimin e kësaj fuqie punëtore për muajin Gusht 2026 është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë se operatori ekonomik disponon një kapacitet real dhe të dokumentuar njerëzor për realizimin e kontratës. Për këtë qëllim, dokumentacioni provues i kërkuar, konkretisht listëpagesa për muajin Gusht 2026 dhe vërtetimi i administratës tatimore për numrin e punonjësve të siguruar, siguron verifikueshmërinë e këtij kapaciteti.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor të nevojshëm për zbatimin e punimeve, si më poshtë:

<i>Nr. Pozicioni</i>	<i>Numri</i>
1 Agronom	1 (një)
2 Teknik ndërtimi	1 (një)
3 Murator	2 (dy)
4 Karpentier	1 (një)
5 Saldator	1 (një)
6 Manovrator	1 (një)
7 Bojaxhi	1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e personelit të sipërcituar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës përkatëse të DST-së.

Operatori ekonomik i renditur i pari, pas përfundimit të procesit të vlerësimit, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- Kontratat individuale të punës, të vlefshme;*
- Dëshmitë e kualifikimit dhe të sigurimit teknik, kur kërkohen sipas natyrës së pozicionit dhe legjislacionit në fuqi, të lëshuara nga institucionet shtetërore ose nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë;*

- *Për pozicionin agronom, diplomë universitare ose dokument ekuivalent që provon kualifikimin përkatës;*
- *Për pozicionin teknik ndërtimi, diplomë, dëshmi kualifikimi ose dokument ekuivalent që provon kualifikimin përkatës.*

Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i vlefshëm dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkojnë specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr.15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Përcaktimi i kriterit të kualifikimit sipas të cilit operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë personelin kryesor të nevojshëm për zbatimin e punimeve, konkretisht 1 (një) Agronom, 1 (një) Teknik ndërtimi, 2 (dy) Muratorë, 1 (një) Karpentier, 1 (një) Saldator, 1 (një) Manovrator dhe 1

(një) Bojaxhi, është bërë duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin teknik, shumëllojshmërinë dhe mënyrën e realizimit të punimeve të parashikuara për objektin “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”.

Objekti përfshin një sërë procesesh ndërtimore dhe sistemimi të territorit, të cilat kërkojnë ndërthurjen e punimeve të ndryshme dhe angazhimin e personelit me profesione dhe aftësi specifike. Për këtë arsye, kërkesa për personelin e përcaktuar në kriter nuk lidhet vetëm me numrin e përgjithshëm të punonjësve, por me nevojën për të garantuar që çdo proces pune të realizohet nga punonjës me përvojën dhe kualifikimin e përshtatshëm.

Agronomi është parashikuar për shkak të natyrës së objektit dhe ndërhyrjeve në territorin e hapësirave të varrezave, ku përfshihen punime shpyllëzimi, prerje dhe sistemim pemësh, skarifikim bari dhe sistemim i sipërfaqeve të gjelbra. Prania e një specialisti të kësaj fushe shërben për orientimin dhe kontrollin e ndërhyrjeve në elementet bimore dhe në sipërfaqet e gjelbra, duke garantuar që punimet e pastrimit, sistemimit dhe ndërhyrjes në territor të kryhen në mënyrë të përshtatshme dhe të kontrolluar.

Tekniku i ndërtimit është i nevojshëm për mbështetjen teknike dhe organizimin e proceseve të zbatimit të punimeve, kontrollin e përputhshmërisë së punimeve me projektin, preventivin dhe kërkesat teknike, si dhe për koordinimin e proceseve të ndryshme të punës në kantier. Duke qenë se objekti përfshin punime dheu, betonarmeje, murature, çatie, suvatimi, shtresash dhe rrethimi, nevoja për një person me formim teknik në fushën e ndërtimit është e drejtpërdrejtë.

Dy muratorët janë përcaktuar për shkak të volumit dhe natyrës së punimeve të muraturës së parashikuara në preventiv, veçanërisht për realizimin e mureve prej guri deri në lartësinë 3 m me llaç çimentoje M25. Këto punime kërkojnë punë të specializuar dhe mund të zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazave përkatëse të zbatimit. Disponimi i dy muratorëve mundëson realizimin më efektiv të këtyre proceseve dhe respektimin e afatit të kontratës.

Karpentieri është i nevojshëm për proceset që lidhen me punimet e drurit dhe elementet ndihmëse të procesit të ndërtimit, si dhe për realizimin dhe përshtatjen e elementeve të nevojshme gjatë punimeve të betonit, çatisë dhe konstruksioneve përkatëse. Duke pasur parasysh se në objekt parashikohen edhe punime të çatisë dhe ndërhyrje konstruktive, prania e këtij pozicioni siguron specialistin e nevojshëm për këto procese.

Saldatori është kërkuar për shkak të punimeve metalike të parashikuara në preventiv, veçanërisht për portat metalike dekorative rrëshqitëse dhe rrethimin me kangjella dhe panele çeliku të zinguar, si dhe për punimet e montimit, përshtatjes dhe lidhjes së elementeve metalike. Disponimi i një punonjësi të specializuar në saldim garanton që këto punime të realizohen sipas kërkesave teknike dhe me sigurinë e nevojshme.

Manovratori është i nevojshëm për operimin e mjeteve dhe makinerive të parashikuara për punimet e terrenit, veçanërisht për gërmimet me ekskavator me zinxhir me kovë 0.5 m³, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve dhe punimet e tjera mekanike të tokës. Kërkesa për këtë pozicion lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe me nevojën për të garantuar përdorimin e sigurt dhe teknikisht të përshtatshëm të makinerive.

Bojaxhiu është parashikuar për realizimin e punimeve të bojatisjes dhe trajtimit të sipërfaqeve, përfshirë lyerjen e sipërfaqeve metalike dhe elementeve të parashikuara në preventiv. Ky pozicion është i nevojshëm për garantimin e përfundimit cilësor të punimeve dhe mbrojtjen e sipërfaqeve metalike nga ndikimet atmosferike dhe faktorët e tjerë të jashtëm.

Përcaktimi i këtij personeli është bërë gjithashtu duke marrë në konsideratë faktin se punimet nuk kanë karakter të njëtrajtshëm, por përfshijnë procese të ndryshme që mund të zhvillohen në mënyrë të njëpasnjëshme dhe, sipas organizimit të kantierit, edhe paralelisht. Për këtë arsye, kërkesa për personel të specializuar synon të sigurojë kapacitetin teknik dhe organizativ të nevojshëm për realizimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar kontraktor.

Personeli i kërkuar është i lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe nuk përbën një kërkesë të përgjithshme apo të shkëputur nga objekti i prokurimit. Çdo pozicion i përcaktuar ka një funksion konkret në realizimin e punimeve, duke mbuluar përkatësisht proceset e sistemit të territorit, punimet e ndërtimit, muraturën prej guri, punimet e drurit dhe të çatisë, punimet metalike, përdorimin e makinerive dhe punimet e bojatisjes.

Kërkesa për paraqitjen e kontratave individuale të punës, dëshmive të kualifikimit dhe sigurimit teknik, kur kërkohen sipas natyrës së pozicionit dhe legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve të kualifikimit për agronomin dhe teknikun e ndërtimit, synon të garantojë që personeli i deklaruar nga operatori ekonomik të jetë realisht i disponueshëm dhe të zotërojë kompetencat profesionale të nevojshme për kryerjen e detyrave përkatëse.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për të dëshmuar se disponon kapacitetet dhe sistemet e nevojshme për realizimin e punimeve duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë:

- ISO 9001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të cilësisë;
- ISO 14001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit mjedisor;
- ISO 45001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- PAS 99 ose ekuivalente, për sistemin e integruar të menaxhimit.

Përmbushja e këtij kriteri do të dëshmohet nëpërmjet vetëdeklarimit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues do të paraqitet nga operatori ekonomik i renditur i pari, sipas kërkesave të DST-së.

Në rastin e paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatat përkatëse sipas zërave të punimeve që merr përsipër të realizojë, në përputhje me përcaktimet e Kontratës së Bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.

nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Përcaktimi i kriterit të kualifikimit sipas të cilit operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë certifikatat ISO 9001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të cilësisë, ISO 14001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit mjedisor, ISO 45001 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe PAS 99 ose ekuivalente për sistemin e integruar të menaxhimit, është bërë duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin, shumëllojshmërinë dhe kushtet konkrete të realizimit të punimeve për objektin “Sistemi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”.

Objekti përfshin një numër të konsiderueshëm procesesh ndërtimore dhe ndërhyrjesh në territor, të cilat kërkojnë një organizim të kontrolluar të punës dhe zbatim të procedurave të përcaktuara për cilësinë, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë. Në preventiv janë parashikuar, ndër të tjera, punime shpyllëzimi dhe sistemimi të territorit, punime dheu, gjurmime me mjete mekanike, transport dhe largim materiale, punime betoni dhe beton-arme, punime hekuri, punime murature guri, punime çatie, suvatimi dhe bojatisjeje, punime shtresash, vendosje pllakash guri, punime metalike dhe rrethime me panele çeliku të zinguar.

Këto procese pune përfshijnë përdorimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit, mjeteve dhe makinerive, si dhe angazhimin e fuqisë punëtore në procese që mund të zhvillohen në mënyrë të njëpasnjëshme ose paralele. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor e ka konsideruar të nevojshme që operatori ekonomik të dëshmojë se disponon një sistem të strukturuar menaxhimi, i cili mundëson planifikimin, kontrollin dhe dokumentimin e proceseve të punës gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Certifikata ISO 9001 ose ekuivalente lidhet drejtpërdrejt me nevojën për garantimin dhe kontrollin e cilësisë së punimeve. Duke qenë se objekti përfshin punime të ndryshme ndërtimore, si punime dheu, beton, beton-arme, hekur, muraturë guri, suvatime, bojatisje, shtresa dhe punime metalike, është e rëndësishme që operatori ekonomik të ketë një sistem të organizuar për kontrollin e cilësisë së proceseve, materialeve dhe produkteve të realizuara. Një sistem i tillë ndihmon në sigurimin e përputhshmërisë së punimeve me projektin, preventivin, specifikimet teknike dhe kërkesat kontraktore.

Certifikata ISO 14001 ose ekuivalente është e lidhur me karakterin e ndërhyrjeve në territor dhe me nevojën për administrimin e ndikimeve mjedisore gjatë zbatimit të punimeve. Në kuadër të objektit parashikohen punime shpyllëzimi, prerje dhe sistemim pemësh, skarifikim bari, gjurmime, transport dheu e materiale, përdorim makinerish dhe mjeteve të transportit, si dhe krijim dhe menaxhim të mbetjeve të ndryshme të procesit të ndërtimit. Për këtë arsye, kërkesa synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një sistem të përshtatshëm për identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve në mjedis, si dhe për administrimin e mbetjeve dhe materialeve të krijuara gjatë punimeve.

Certifikata ISO 45001 ose ekuivalente lidhet me nevojën për garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë gjatë realizimit të kontratës. Punimet e parashikuara përfshijnë procese që mbartin rreziqe të ndryshme profesionale, si përdorimi i ekskavatorëve dhe mjeteve të tjera mekanike, gjurmimet, transporti i materialeve, punimet me beton dhe hekur, saldimi, punimet në lartësi, punimet e muraturës, punimet metalike dhe përdorimi i mjeteve elektrike dhe mekanike. Në këto kushte,

disponimi i një sistemi të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë synon të garantojë identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese dhe organizimin e punës në kushte të sigurta për punonjësit dhe personat e tjerë të pranishëm në kantier.

Ndërkohë, kërkesa për PAS 99 ose ekuivalente, për sistemin e integruar të menaxhimit, lidhet me nevojën për koordinimin e sistemeve të ndryshme të menaxhimit në kuadër të një strukture të integruar organizative. Duke qenë se kontrata përfshin njëkohësisht kërkesa për cilësinë e punimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e sigurinë në punë, një sistem i integruar ndihmon operatorin ekonomik në koordinimin e këtyre elementeve dhe në zbatimin e tyre në mënyrë të njëtrajtshme gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa për këto certifikata nuk synon vetëm ekzistencën formale të dokumenteve, por dëshmimin se operatori ekonomik disponon kapacitete dhe sisteme të organizuara menaxhimi, të përshtatshme për natyrën e punimeve që do të realizohen. Certifikimi nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, garanton një nivel të verifikueshëm të përputhshmërisë së sistemeve të menaxhimit të operatorit ekonomik me standardet përkatëse.

Përcaktimi i kërkesës për certifikata “ose ekuivalente” synon gjithashtu të sigurojë që kriteri të mos kufizojë konkurrencën vetëm te operatorët që disponojnë një certifikatë të një emërtimi të caktuar, por të lejojë edhe dëshmimin e sistemeve të barasvlershme, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikatat përkatëse sipas zërave të punimeve që merr përsipër të realizojë në bazë të Kontratës së Bashkëpunimit, është përcaktuar me qëllim që kapacitetet e pretenduara të jenë realisht të lidhura me pjesën konkrete të punimeve që do të realizojë secili anëtar. Në këtë mënyrë, shmangët kërkimi i një kapaciteti të shkëputur nga detyrimet konkrete që merr përsipër secili operator ekonomik.

Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme në momentin e paraqitjes së dokumentacionit provues dhe të jenë lëshuar nga organe kompetente dhe të akredituara siguron që sistemet e deklaruara të menaxhimit të jenë aktive dhe të verifikueshme gjatë procesit të prokurimit.

Kërkesa për ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001 dhe PAS 99, ose ekuivalentet e tyre, është përcaktuar në funksion të karakteristikave konkrete të objektit “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”, të shumëllojshmërisë së proceseve të punës dhe nevojës për realizimin e tyre në mënyrë cilësore, të sigurt dhe me ndikim të kontrolluar në mjedis. Këto kërkesa synojnë të garantojnë që operatori ekonomik të ketë një strukturë të organizuar dhe të dokumentuar për menaxhimin e cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë dhe, në këtë mënyrë, të sigurojë realizimin me sukses të kontratës brenda kërkesave teknike dhe kontraktore të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjeti/Makineria/Pajisja	Sasia	Forma e disponimit
1	Kamion vetëshkarkues me vinç, me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	1 copë	Pronësi ose qira
2	Kamion me kapacitet mbajtës deri në 2 ton	1 copë	Pronësi ose qira
3	Ekskavator me goma	1 copë	Pronësi ose qira
4	Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose qira

5	Motobetoniere	1 copë	Pronësi ose qira
6	Depozitë uji me kapacitet $\geq 5\,000$ litra	1 copë	Pronësi ose qira
7	Kaskë mbrojtëse (“kokore”)	10 copë	Pronësi ose qira
8	Pompë uji	1 copë	Pronësi ose qira
9	Kuti të ndihmës së shpejtë	5 copë	Pronësi ose qira
10	Motogjenerator	1 copë	Pronësi ose qira
11	Motosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose qira
12	Fabrikë për prodhimin e betonit	1 copë	Pronësi ose qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës përkatëse të DST-së.

Dokumentacioni provues

Për mjetet dhe makineritë në pronësi, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- dokumentin që provon pronësinë e mjetit/makinerisë;
- lejen e qarkullimit, për mjetet që pajisen me të;
- certifikatën e vlefshme të kontrollit teknik, kur është e aplikueshme;
- policën e sigurimit të detyrueshëm, të vlefshme, kur është e aplikueshme;
- dokumentin që provon shlyerjen e detyrimeve/taksave përkatëse, kur është e aplikueshme;
- fotografi të mjetit/makinerisë, ku të identifikohen qartë karakteristikat dhe të dhënat e tij.

Për mjetet dhe makineritë me qira, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratën e qirasë, të vlefshme;
- lejen e qarkullimit, për mjetet që pajisen me të;
- certifikatën e vlefshme të kontrollit teknik, kur është e aplikueshme;
- policën e sigurimit të detyrueshëm, të vlefshme, kur është e aplikueshme;
- dokumentin që provon shlyerjen e detyrimeve/taksave përkatëse, kur është e aplikueshme;
- fotografi të mjetit/makinerisë, ku të identifikohen qartë karakteristikat dhe të dhënat e tij.

Për mjetet, makineritë ose pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon pronësinë ose disponimin e tyre, si kontratë shitblerjeje, faturë tatimore, dokument zhdoganimi ose dokument tjetër të vlefshëm sipas legjislacionit në fuqi, shoqëruar me fotografi të pajisjes.

Shënim: Kërkesa për disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës përkatëse të DST-së. Dokumentacioni provues paraqitet nga operatori ekonomik i renditur i pari pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit, ose kur Autoriteti Kontraktor e kërkon për qëllime verifikimi dhe sqarimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë gjithashtu një deklaratë mbi vendndodhjen e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve, në pronësi ose me qira, si dhe të deklarojë se pranon verifikimin fizik të tyre nga Autoriteti Kontraktor, në çdo kohë gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mjetet, makineritë dhe pajisjet e deklaruarat për përmbushjen e këtij kriteri nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera në mënyrë të tillë që të pengojë vënien e tyre në dispozicion për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë deklaruar si

mjete të disponueshme për realizimin e kontratave të tjera të shpallura fituese, në masën që një angazhim i tillë cenon disponueshmërinë e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Përcaktimi i kriterit të kualifikimit sipas të cilit operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e përcaktuara në dokumentet e tenderit është bërë duke marrë në konsideratë natyrën, volumin, kompleksitetin dhe mënyrën e realizimit të punimeve të parashikuara për objektin “Sistemi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave”, si dhe nevojën për realizimin e tyre brenda afatit kontraktor prej 90 ditësh kalendarike.

Objekti përfshin një gamë të gjerë punimesh, duke filluar nga punimet e shpyllëzimit dhe sistemit të territorit, punimet e dheut dhe gërmimet, transportin dhe largimin e materialeve, punimet e betonit dhe beton-armës, punimet e hekurit, muraturën prej guri, punimet e çatisë, suvatimit dhe bojatisjes, shtresat në territor, vendosjen e pllakave prej guri, si dhe punimet metalike dhe rrethimin me kangjella e panele çeliku të zinguar.

Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme, pasi një pjesë e konsiderueshme e punimeve nuk mund të realizohet në mënyrë efikase vetëm me mjete manuale. Për këtë arsye, kërkesa për mjetet dhe makineritë është përcaktuar mbi bazën e funksionit konkret që secila prej tyre ka në realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv.

Kamioni vetëshkarkues me vinç, me kapacitet mbajtës mbi 5 ton, është i nevojshëm për transportin, ngarkimin, shkarkimin dhe zhvendosjen e materialeve të ndërtimit, dheut, zhavorrit, gurëve dhe materialeve të tjera të nevojshme për realizimin e objektit. Pajisja me vinç mundëson gjithashtu manipulimin dhe pozicionimin e materialeve në kantier, duke rritur eficiencën e punës dhe duke reduktuar nevojën për manipulim manual të ngarkesave të rënda.

Kamioni me kapacitet mbajtës deri në 2 ton është parashikuar për transportin e materialeve dhe mjeteve në distanca dhe zona ku përdorimi i një automjeti me kapacitet më të madh mund të jetë i vështirë ose joefektiv. Duke pasur parasysh natyrën e territorit dhe nevojën për transport të materialeve në zona të ndryshme të kantierit, ky mjet shërben për furnizimin e vazhdueshëm të frontit të punimeve.

Ekskavatori me goma është i domosdoshëm për realizimin e punimeve të dheut të parashikuara në preventiv, veçanërisht për gërmimet, hapjen dhe sistemimin e terrenit, ngarkimin e materialeve dhe punime të tjera mekanike. Përdorimi i ekskavatorit siguron realizimin e këtyre proceseve me produktivitet të përshtatshëm dhe brenda afatit të përcaktuar kontraktor.

Autobetoniere është e nevojshme për transportin dhe përzierjen e betonit gjatë realizimit të punimeve të betonit dhe beton-armës. Në preventiv janë parashikuar punime me beton dhe beton-arme, përfshirë elemente prej betoni C12/15, të cilat kërkojnë furnizim të kontrolluar dhe të vazhdueshëm me beton në frontin e punimeve.

Motobetoniere është parashikuar për përgatitjen dhe përzierjen e betonit në kantier, veçanërisht në rastet kur nevojiten sasi të përshtatura sipas fazave të punës ose kur distanca dhe organizimi i kantierit kërkojnë përgatitje të betonit pranë vendit të zbatimit. Kjo pajisje rrit fleksibilitetin e procesit të punës dhe siguron vazhdimësinë e punimeve.

Depozita e ujit me kapacitet jo më të vogël se 5,000 litra është e nevojshme për sigurimin e furnizimit me ujë në kantier, për nevojat teknologjike të punimeve, për përgatitjen dhe përpunimin e materialeve, mirëmbajtjen e proceseve të betonimit, si dhe për nevoja të tjera të lidhura me organizimin dhe funksionimin e kantierit. Disponimi i një rezerve të mjaftueshme uji garanton vijueshmërinë e punimeve edhe në rast të kufizimeve ose ndërprerjeve të përkohshme të furnizimit. 10 kaska mbrojtëse (“kokore”) janë parashikuar në funksion të numrit të punonjësve dhe të kërkesave për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë. Duke pasur parasysh se në objekt parashikohet angazhimi i një fuqie punëtore minimale prej 16 punonjësish, si dhe natyrën e punimeve ndërtimore, është e nevojshme që punonjësit që angazhohen në frontet e punës të pajisen me pajisjet e përshtatshme mbrojtëse individuale, në përputhje me rreziqet e proceseve konkrete të punës.

Pompa e ujit është e nevojshme për menaxhimin dhe përdorimin e ujit në kantier, për furnizimin e zonave të punës dhe për ndërhyrje të ndryshme teknike që mund të lindin gjatë realizimit të punimeve. Ajo mundëson kontrollin dhe zhvendosjen e ujit në funksion të nevojave të procesit të punës.

5 kuti të ndihmës së shpejtë janë parashikuar për të garantuar mundësinë e dhënies së ndihmës së parë në rast incidentesh apo dëmtimesh të mundshme gjatë punimeve. Numri i tyre lidhet me nevojën për t'i pasur ato të aksesueshme në zona të ndryshme të kantierit dhe pranë fronteve të punës, duke marrë në konsideratë shtrirjen e aktivitetit dhe natyrën e punimeve.

Motogeneratori është i nevojshëm për sigurimin e energjisë elektrike në rast të mungesës ose ndërprerjes së furnizimit me energji në kantier. Disponimi i tij garanton vijueshmërinë e proceseve të punës që kërkojnë energji elektrike dhe shmang ndërprerjet e panevojshme të aktivitetit të kantierit.

Motosaldatrici është e nevojshme për realizimin e punimeve metalike dhe ndërhyrjeve të lidhura me elementet prej çeliku, veçanërisht për punimet e rrethimit, kangjellave, paneleve të çelikut të zinguar, portave metalike dhe elementeve të tjera metalike të parashikuara në preventiv. Disponimi i saj mundëson kryerjen e punimeve të saldimit dhe përshtatjeve të nevojshme drejtpërdrejt në kantier.

Fabrika për prodhimin e betonit është parashikuar për të garantuar disponueshmërinë dhe furnizimin e kontrolluar me beton për realizimin e elementeve të betonit dhe beton-armës të parashikuara në preventiv. Duke pasur parasysh përfshirjen e punimeve me beton C12/15 dhe elementeve të tjera të betonit, disponimi i një burimi të kontrolluar për prodhimin e betonit

ndihmon në garantimin e vazhdimësisë së punimeve dhe të përputhshmërisë së betonit me kërkesat teknike të projektit.

Tërësia e këtyre mjeteve, makinerive dhe pajisjeve është përcaktuar në funksion të proceseve konkrete të punës dhe nuk përbën një kërkesë të shkëputur nga objekti i prokurimit. Çdo mjet ose pajisje ka një funksion të drejtpërdrejtë në realizimin e një ose më shumë zërave të preventivit dhe kontribuon në garantimin e kapacitetit operacional të operatorit ekonomik.

Përcaktimi i tyre lidhet edhe me volumin e përgjithshëm të punës prej 11,520 orësh, i cili, duke u realizuar brenda afatit prej 90 ditësh kalendarike, kërkon një organizim të efektshëm të mjeteve dhe makinerive, në mënyrë që proceset e punës të mos pengojnë njëra-tjetrën dhe të mundësohet realizimi i punimeve në kohë.

Në këtë kuadër, kërkesa për disponimin e mjeteve dhe makinerive në pronësi ose me qira është përcaktuar për të garantuar fleksibilitetin e operatorëve ekonomikë dhe për të mos kufizuar pjesëmarrjen vetëm te operatorët që i kanë këto mjete në pronësi. Në të dyja rastet kërkohet që disponimi të jetë real, i vlefshëm dhe i verifikueshëm, në mënyrë që mjetet dhe pajisjet të jenë efektivisht në dispozicion për realizimin e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e dokumenteve të pronësisë ose të kontratës së qirasë, lejeve të qarkullimit, certifikatave të kontrollit teknik, policave të sigurimit, dokumenteve për shlyerjen e detyrimeve përkatëse dhe fotografive të mjeteve, kur këto janë të aplikueshme, synon të sigurojë verifikueshmërinë dhe ekzistencën reale të kapaciteteve të deklaruara nga operatori ekonomik.

Gjithashtu, kërkesa për deklarimin e vendndodhjes së mjeteve, makinerive dhe pajisjeve dhe pranimin e verifikimit fizik nga Autoriteti Kontraktor synon të garantojë se kapacitetet e deklaruara nuk janë vetëm formale, por janë realisht të disponueshme dhe mund të vihen në përdorim për realizimin e kontratës.

Deklarimi se mjetet dhe makineritë e paraqitura nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera në mënyrë të tillë që pengon vënien e tyre në dispozicion për këtë kontratë është përcaktuar me qëllim që operatori ekonomik të garantojë disponueshmërinë efektive dhe ekskluzive të kapaciteteve të nevojshme gjatë periudhës së zbatimit, duke shmangur situatat në të cilat i njëjti mjet deklarohet njëkohësisht për kontrata të ndryshme dhe nuk mund të përdoret realisht.

Për rrjedhojë, kriteri 2.3.5 është përcaktuar në mënyrë të lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit, natyrën e punimeve, volumin e tyre, kushtet e realizimit dhe afatin 90-ditor të kontratës. Disponimi i këtyre mjeteve, makinerive dhe pajisjeve siguron kapacitetin teknik dhe operacional të nevojshëm për realizimin e punimeve të shpyllëzimit, gërmimeve, transportit, betonimit, punimeve metalike, sistemimit të territorit dhe proceseve të tjera të parashikuara, duke garantuar realizimin e objektivit në mënyrë cilësore, të sigurt dhe brenda afatit të përcaktuar kontraktor.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike, relacioni teknik, preventivi i punimeve, vizatimet teknike, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave” janë hartuar nga projektuesi i licencuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktet nënligjore për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, standardet teknike shqiptare dhe europiane, si dhe rregullat e praktikës së mirë inxhinierike.

Objekti i investimit konsiston në sistemimin dhe zgjerimin e hapësirave të varrezave, me qëllim krijimin e hapësirave të përshtatshme dhe funksionale, përmirësimin e organizimit të territorit,

ndërtimin dhe sistemimin e elementeve të nevojshme infrastrukturore dhe mbështetëse, si dhe garantimin e kushteve të përshtatshme të përdorimit, aksesit, sigurisë dhe mirëmbajtjes së territorit. Zgjidhja teknike është përcaktuar duke marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese të territorit, nevojën për zgjerimin dhe sistemimin e sipërfaqeve, karakteristikat e terrenit, punimet e pastrimit dhe shpyllëzimit, punimet e gërmimit dhe transportit të materialeve, ndërtimin e elementeve prej betoni dhe betonarmeje, realizimin e mureve prej guri, punimet e mbulimit dhe hidroizolimit, sistemimin e sipërfaqeve të jashtme, si dhe rrethimin dhe sigurimin e hapësirave të ndërhyrjes.

Referuar preventivit të punimeve, realizimi i objektit përfshin punime shpyllëzimi dhe pastrimi të territorit, punime dheu dhe gërmimi, punime për vepra arti dhe kanalizime, punime betoni dhe betonarmeje, punime hekuri, punime hidroizolimi dhe çatie, muraturë guri, suvatime dhe tavane, punime bojatisjeje, shtresa në territor, vendosje pllakash guri, si dhe punime rrethimi me panele çeliku të zinguar.

Këto procese janë të lidhura funksionalisht dhe teknologjikisht dhe duhet të realizohen sipas një rendi të përshtatshëm pune, në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria, siguria, funksionaliteti, aksesueshmëria dhe jetëgjatësia e hapësirave të sistemuara.

1. Punime shpyllëzimi dhe pastrimi të territorit

Në preventiv janë parashikuar zëra për prerjen dhe sistemimin e pemëve, si dhe skarifikimin e barit me lopatë. Këto punime janë të nevojshme për përgatitjen e territorit për ndërhyrjet e mëtejshme dhe për krijimin e sipërfaqeve të lira e të përshtatshme për realizimin e punimeve të zgjerimit dhe sistemimit të varrezave. Prerja dhe sistemimi i pemëve duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kufijtë e zonës së ndërhyrjes dhe duke shmangur dëmtimin e elementeve ekzistuese që duhet të ruhen. Pastrimi dhe skarifikimi i sipërfaqes së barit siguron largimin e shtresës bimore dhe përgatitjen e terrenit për punimet e gërmimit, nivelimit dhe ndërtimit.

Këto procese janë të rëndësishme për krijimin e një baze të përshtatshme për fazat pasuese të punimeve dhe për garantimin e realizimit të tyre sipas kuotave dhe konfigurimit të përcaktuar në projekt.

2. Punime dheu, gërmime dhe transport

Në preventiv janë parashikuar zëra për transportin e materialeve të ndërtimit, transportin e dheut me auto, gërmimin e dheut për themele dhe plinta me thellësi deri në 2 m, gërmimin me ekskavator me zinxhir dhe kovë 0.5 m³, ngarkimin dhe shkarkimin në automjete, si dhe gërmimin dhe transportin me krah deri në 10 m. Punimet e dheut përbëjnë një fazë themelore të sistemimit dhe zgjerimit të territorit. Ato janë të nevojshme për krijimin e kuotave të projektuara, përgatitjen e bazamenteve, themeleve dhe plintave, si dhe për realizimin e elementeve të tjera konstruktive të parashikuara në projekt. Përdorimi i ekskavatorit me zinxhir dhe kovë 0.5 m³ është përcaktuar në funksion të volumit dhe natyrës së gërmimeve të parashikuara dhe mundëson realizimin e punimeve me produktivitet dhe kontroll të përshtatshëm. Gërmimet për themele dhe plinta deri në 2 m duhet të realizohen sipas akseve, kuotave dhe dimensioneve të përcaktuara në projekt, duke garantuar përgatitjen e saktë të bazës për strukturat që do të ndërtohen.

Në zonat ku përdorimi i makinerive është i kufizuar për shkak të konfigurimit të territorit ose afërsisë me elemente ekzistuese, parashikimi i gërmimit dhe transportit me krah deri në 10 m mundëson realizimin e ndërhyrjeve në mënyrë të kontrolluar dhe pa cenuar strukturat përreth.

Transporti i dheut dhe materialeve të ndërtimit është i domosdoshëm për largimin e materialeve të tepërta, furnizimin e kantierit dhe vijimin normal të proceseve të ndërtimit.

3. Ndërtimi i veprave të artit dhe kanalizimeve

Në preventiv është parashikuar zëri për prerje të strukturave prej betoni, në funksion të ndërhyrjeve të parashikuara për veprat e artit dhe kanalizimet. Këto punime janë të nevojshme për përshtatjen, modifikimin ose realizimin e elementeve të nevojshme për sistemin e ujërave dhe funksionimin e infrastrukturës së territorit. Realizimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me projektin dhe detajet teknike, duke garantuar që ndërhyrjet të mos ndikojnë negativisht në strukturat ekzistuese dhe që elementet e reja të kenë lidhjen dhe funksionalitetin e kërkuar. Punimet e kanalizimeve dhe veprave të artit kanë rëndësi të veçantë për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore, mbrojtjen e territorit nga grumbullimi dhe erozioni i ujërave dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë së sipërfaqeve të sistemuara.

4. Punime betoni dhe betonarmeje

Në preventiv është parashikuar zëri “Brez betonarmeje monolite C12/15”. Realizimi i brezave prej betoni dhe betonarmeje është i nevojshëm për krijimin e elementeve konstruktive dhe mbështetëse të parashikuara në projekt. Betoni duhet të përgatitet, transportohet, vendoset, ngjeshet dhe kurohet në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat e projektit dhe standardet teknike përkatëse. Klasa e betonit C12/15 është përcaktuar mbi bazën e funksionit të elementeve konkrete ku përdoret dhe të kërkesave të projektit.

Gjatë zbatimit duhet të kontrollohen në veçanti:

- kuotat dhe dimensionet e elementeve;
- përgatitja e bazës;
- pozicionimi i armaturës;
- mbulimi i armaturës;
- cilësia dhe përbërja e betonit;
- vendosja dhe ngjeshja e betonit;
- kurimi i betonit;
- përputhja e punimeve me projektin dhe detajet konstruktive.

5. Punime hekuri dhe shtresa betoni

Në preventiv janë parashikuar shtresë betoni C12/15 me zgarë hekuri dhe vendosje e hekurit të betonit periodik me diametër 6–10 mm. Shtresat e betonit të armuar janë të nevojshme për realizimin e sipërfaqeve dhe elementeve konstruktive të përcaktuara në projekt, duke siguruar qëndrueshmëri dhe rezistencë ndaj ngarkesave të parashikuara. Përdorimi i hekurit të betonit periodik me diametër 6–10 mm është përcaktuar në funksion të zgjidhjes konstruktive të projektit dhe duhet të realizohet sipas pozicionit, distancave, ankorimeve dhe detajeve të përcaktuara në dokumentacionin teknik. Përpara betonimit duhet të verifikohet vendosja e saktë e zgarës dhe armaturës, duke garantuar mbulimin e kërkuar dhe pozicionimin sipas projektit.

6. Punime hidroizolimi dhe çatie

Në preventiv është parashikuar zëri “Mbulim çatie me panele sandwich”. Përdorimi i paneleve sandwich është parashikuar për realizimin e mbulesës së çatisë së elementeve të ndërtesës të përfshira në projekt. Ky material siguron mbrojtjen e hapësirave të brendshme ndaj reshjeve atmosferike dhe kontribuon në qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e mbulesës. Montimi duhet të realizohet sipas karakteristikave teknike të materialit dhe detajeve të projektit, duke garantuar fiksimin e përshtatshëm, pjerrësinë e nevojshme, mbrojtjen nga depërtimi i ujit dhe përputhjen me strukturën mbajtëse.

7. Punime murature prej guri

Në preventiv është parashikuar zëri “Mur guri në lartësi deri në 3 m me llaç çimento M25”. Muret prej guri janë të nevojshme për realizimin e elementeve mbajtëse, kufizuese ose sistemuese të territorit, sipas zgjidhjes së projektit. Përdorimi i gurit në kombinim me llaç çimentoje M25 siguron një strukturë të përshtatshme për kushtet e përdorimit dhe kontribuon në qëndrueshmërinë e elementeve të ndërtuara. Realizimi i muraturës duhet të respektojë lartësinë, trashësinë, lidhjen e gurëve, cilësinë e materialit, përgatitjen e llaçit, vertikalishtet dhe kuotat e përcaktuara në projekt. Për mure me lartësi deri në 3 m, kontrolli i qëndrueshmërisë dhe i mënyrës së realizimit është veçanërisht i rëndësishëm për të shmangur deformimet, çarjet ose dëmtimet gjatë shfrytëzimit.

8. Punime tavani dhe suvatimi

Në preventiv janë parashikuar punime për suva fasade me granil dhe çimento të bardhë, me trashësi 8 mm. Suvatimi i fasadave shërben për mbrojtjen e sipërfaqeve të ndërtësive, përmirësimin e rezistencës ndaj ndikimeve atmosferike dhe realizimin e përfundimit estetik të sipërfaqeve.

Përgatitja e bazës, përbërja e materialit, trashësia e shtresës dhe mënyra e aplikimit duhet të realizohen në përputhje me specifikimet e projektit dhe karakteristikat e materialeve të përdorura.

9. Punime bojatisjeje dhe elemente metalike

Në preventiv janë parashikuar vendosja e portës metalike dekorative rrëshqitëse dhe lysterja e sipërfaqeve metalike. Porta metalike shërben për kontrollin e aksesit në territorin e varrezave dhe për rritjen e sigurisë së hapësirës. Zgjidhja rrëshqitëse është e përshtatshme për kontrollin e hyrje-daljeve dhe përdorimin racional të hapësirës. Lysterja e sipërfaqeve metalike ka funksion mbrojtës ndaj korrozionit dhe ndikimeve atmosferike, si dhe funksion përfundimtar estetik. Përgatitja e sipërfaqes dhe aplikimi i bojës duhet të kryhen sipas kërkesave teknike dhe specifikimeve të projektit.

10. Nënshtrësas dhe shtrësas në territor

Në preventiv është parashikuar zëri “Shtrësë zhavorri”. Shtrësja e zhavorrit është e nevojshme për sistemimin e sipërfaqeve të territorit dhe krijimin e një nënshtrëse të përshtatshme për hapësirat e parashikuara në projekt.

Përdorimi i saj kontribuon në stabilizimin e sipërfaqes, përmirësimin e drenazhimit dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për lëvizjen dhe mirëmbajtjen e territorit. Materiali duhet të jetë i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar dhe të vendoset sipas kuotave dhe trashësive të përcaktuara në projekt.

11. Vendosja e pllakave prej guri

Në preventiv është parashikuar zëri “F.V. i pllakave prej guri të thjeshta”. Vendosja e pllakave prej guri është parashikuar për sistemimin dhe përmirësimin e sipërfaqeve të caktuara të territorit, duke krijuar ambiente më të qëndrueshme, të aksesueshme dhe të përshtatshme për përdorim. Pllakat duhet të vendosen mbi bazamentin e përgatitur, duke respektuar kuotat, pjerrësitë, nivelimin dhe mënyrën e fiksimit të përcaktuar në projekt. Ky proces kontribuon në përmirësimin e aksesueshmërisë, mirëmbajtjes dhe funksionalitetit të hapësirave të varrezave.

12. Rrethimi me panele çeliku të zinguar

Në preventiv është parashikuar rrethim me kangjella me panel çeliku të zinguar.

Rrethimi është një element i domosdoshëm për përcaktimin fizik të kufijve të territorit, kontrollin e aksesit dhe mbrojtjen e hapësirave të varrezave. Përdorimi i paneleve prej çeliku të zinguar siguron rezistencë të përshtatshme ndaj kushteve atmosferike dhe redukton rrezikun e korrozionit, duke kontribuar në jetëgjatësinë e rrethimit dhe në uljen e nevojave për mirëmbajtje. Montimi

duhet të kryhet në përputhje me dimensionet, distancat ndërmjet elementeve, mënyrën e ankorimit dhe detajet konstruktive të përcaktuara në projekt.

13. Lidhja teknologjike ndërmjet proceseve të punës

Punimet e parashikuara në preventiv janë të ndërlidhura dhe duhet të realizohen sipas një rendi teknologjik të përshtatshëm. Në mënyrë të përgjithshme, procesi i zbatimit parashikohet të zhvillohet sipas kësaj logjike: Organizimi i kantierit → pastrimi dhe shpyllëzimi i territorit → skarifikimi dhe sistemimi i sipërfaqeve → gërmimet dhe punimet e dheut → ngarkimi dhe transporti i materialeve → realizimi i veprave të artit dhe kanalizimeve → realizimi i themeleve, plintave dhe brezave betonarmeje → vendosja e armaturës → realizimi i shtresave të betonit → realizimi i muraturës prej guri → punimet e çatisë dhe hidroizolimit → suvatimet dhe punimet e përfundimit → bojatisjet dhe elementet metalike → shtresat e territorit → vendosja e pllakave prej guri → realizimi i rrethimit dhe sistemimi përfundimtar i territorit.

Renditja konkrete e proceseve do të përcaktohet në përputhje me projektin, grafikun e punimeve, metodologjinë e zbatimit dhe kushtet reale të kantierit.

Kjo lidhje teknologjike është e rëndësishme pasi punimet e pastrimit dhe gërmimit krijojnë kushtet për realizimin e themeleve dhe elementeve konstruktive, ndërsa këto të fundit duhet të përfundojnë përpara realizimit të punimeve të përfundimit dhe sistemimit të territorit.

14. Kontrolli i cilësisë dhe qëndrueshmërisë

Për shkak të natyrës së objektit, kontrolli i cilësisë duhet të kryhet gjatë të gjitha fazave të zbatimit. Në mënyrë të veçantë duhet të kontrollohen:

- kuotat dhe dimensionet e gërmimeve;
- përgatitja dhe stabiliteti i terrenit;
- cilësia e materialeve të ndërtimit;
- klasa e betonit C12/15;
- diametri dhe pozicionimi i armaturës Ø6–10 mm;
- cilësia e muraturës prej guri dhe llaçit M25;
- realizimi i strukturave dhe elementeve të betonarmeje;
- cilësia dhe mënyra e vendosjes së paneleve sandwich;
- cilësia e suvasë së fasadës;
- realizimi dhe mbrojtja e elementeve metalike;
- nivelimi dhe stabiliteti i shtresave të zhavorrit;
- vendosja dhe fiksimi i pllakave prej guri;
- ankorimi dhe qëndrueshmëria e rrethimit;
- përputhja e punimeve me vizatimet, detajet konstruktive dhe preventivin.

Kontrollet e mësipërme janë të nevojshme për të garantuar që punimet të realizohen në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të sigurojnë qëndrueshmëri, siguri, funksionalitet, aksesueshmëri dhe jetëgjatësi të përshtatshme të objektit.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike, preventivi, relacioni teknik, vizatimet, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin “Sistemimi dhe zgjerimi i hapësirave të varrezave” përbëjnë dokumentacionin teknik të nevojshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe realizimin e punimeve.

Dokumentacioni teknik përcakton qartë punimet që lidhen me pastrimin dhe shpyllëzimin e territorit, gërmimet dhe transportin e dheut, veprat e artit dhe kanalizimet, strukturat prej betoni dhe betonarmeje, armaturën e hekurit, mbulimin me panele sandwich, muraturën prej guri,

suvatimet dhe bojatisjet, shtresat e zhavorrit, vendosjen e pllakave prej guri dhe rrethimin me panele çeliku të zinguar.

Përcaktimi i këtyre zërave dhe parametrave teknikë është bërë në funksion të zgjidhjes teknike të projektit, karakteristikave të territorit, nevojës për zgjerimin dhe sistemimin e hapësirave të varrezave dhe kërkesave për krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme, të sigurt dhe funksionale.

Nëpërmjet këtyre specifikimeve synohet garantimi i realizimit të punimeve sipas parametrave të projektuar, respektimi i kërkesave teknike dhe cilësore dhe përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike, në funksion të interesit publik.

Në këtë kuadër, çdo zë i preventivit është përcaktuar mbi bazën e nevojave konkrete të ndërhyrjes dhe, së bashku me specifikimet teknike, relacionin, vizatimet dhe detajet konstruktive, krijon bazën teknike për realizimin e një hapësire të sistemuar, të sigurt, funksionale dhe të qëndrueshme për përdorim afatgjatë.

NJËSIA E PROKURIMIT